



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40.2 nen c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 6 dhe paragrafit 6 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Ligjit Nr. 08 /L-235 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-213, Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimet e KPF-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt të mbajtur më datën: 22.09.2023, mori këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2022, fondi (22) i vitit 2022 shuma prej 68,922.72.00 € bartën në vitin 2023.

2. Mjetet buxhetore si në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahen në programe dhe nen-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:

- Shpenzime kapitale shuma prej 68,922.72.00 €.

2.1. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektin:

Ndërtimi me gurë i sheshit "Muj Krasniqi" në Klinë, kodi (I Ri) shuma prej 68,922.72.00 euro :

Arsyetim: Nevojë e domosdoshme për përfundimin e projektit në sheshin "Muj Krasniqi" në Klinë

3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

4. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e FEZH, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 601-33945/2023
Klinë, më 22.09/2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi